



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

KORRIK, 2024

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin korrik 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit korrik 2024 zënë 44.1 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 379.92/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 5.31/100.000 banorë. NJVKSH Berat, Kukës dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin korrik 2024 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin korrik 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste korrik 2024	Incidenca korrik 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	6	0.21
Shigelozë (Disenteri bacilare)	11	0.38
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	152	5.31
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	10706	374.02
Sëmundje diarreike në total	10875	379.92

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit korrik 2024 janë raportuar në total 106 raste variçelë (incidenca 3.7/ 100.000 banorë) nga të cilat, 39 raste janë të dyshuara dhe 67 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 32 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 59 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, korrik 2024



2.2 Fruthi

Gjatë muajit korrik janë raportuar 9 raste si të dyshuar me fruth nga të cilat janë konfirmuar 3 raste (33.3%) raste nga ana laboratorike. Incidenca e sëmundjes për muajin korrik është 0.11 raste/100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidenca sipas muajve 2024



Vërehet një trend në rritje në muajin e fundit (korrik) të vitit 2024.


Rastet e konfirmuara janë banorë të bashkisë Tiranë (2) dhe Kuçovë (1). Një rast i përket grup-moshës pediatrike, përkatësisht 11 vjeç, i gjinisë mashkull, i pavaksinuar, i ardhur nga Anglia. Dy rastet e tjera janë të rritur përkatësisht 21 dhe 24 vjeç, të gjinisë femër, të vaksinuara me 1 dozë vaksine FRP. Rastet adulte kanë qenë të shtruara në spital, ndërsa fëmija është ndjekur në rrugë ambulatorie.

3. Hepatitet virale

Hepatiti viral B (HBV)

Në muajin korrik janë raportuar 6 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në muajin korrik është 0.2 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve




Të gjitha rastet në muajin korrik i përkasin grup-moshës adulte nga 24-81 vjeç, janë banorë nga bashkia Dibër (3), Durrës (1), Kuçovë (1) dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV-së.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin korrik nuk është raportuar asnjë rast i konfirmuar me HCV.


Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HCV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve



4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit korrik 2024 janë kryer 34 ekzaminime për HIV (15 femra dhe 19 meshkuj) prej të cilave 11 raste (7 meshkuj dhe 4 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv, grafiku 5.

Grafiku 5. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin korrik 2024.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv në muajin korrik 2024 është: Tiranë 8 raste, Lezhë 1 rast, Sarandë 1 rast dhe Elbasan 1 rast.

Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 16-24 vjeç, 2 raste i përket grup-moshës 25-34 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç, 4 raste i përket grup-moshës 55-64 vjeç dhe 2 raste i përket grup-moshës mbi moshën 65 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 6 raste nga QSUT (3 raste nga Shërbimi Infektiv dhe 3 raste nga klinika ambulatorë), 5 raste vijnë nga laboratorë privat (2 raste – INTERMEDICA, 1 rast nga spitali SALUS dhe 2 raste nga Cambridge).

Gjatë muajit korrik 2024 janë raportuar 3 raste të konfirmuar Sifiliz, 2 raste janë nga Tirana, dhe një rast është nga Shkodra.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit korrik 2024 janë raportuar gjithsej 19 raste me tuberkuloz (TB). Prej të cilave 16 raste janë pulmonar dhe 3 raste ekstrapulmonar. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. 1 prej tyre është recidiv.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 7 në Tiranë, 1 në Lushnje, 1 në Lezhë, 2 në Korçë, 3 në Durrës, 1 në Dibër dhe 1 në Bulqizë. Rastet ekstrapulmonare përkatësisht janë: 1 në Tiranë, 1 në Korçë dhe 1 në Sarandë.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin korrik 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciziozë)

	Korrik (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	3	0.10
Brucelozë	5	0.17
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin korrik janë raportuar 5 raste Brucelozë përkatësisht: 2 nga Gjirokastra, 1 Berat, 1 Lushnje dhe 1 Shkodër. Gjithashtu, janë raportuar 3 raste Antraks nga Gjirokastra. Për muajin korrik Elbasani ka raportuar 1 rast me Rikeciziozë.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19


Gjatë muajit korrik 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 1205 raste të konfirmuara me COVID-19, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin korrik është 42.1 raste /100000 banorë.

Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 99.8 raste për 100000 banorë e ndjekur nga grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 73.43 raste për 100000 banorë. Gjatë këtij muaji vërehet një rritje e incidencës në grup-moshën 0-4 vjeç.

Grafiku 7. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive



Bashkitë me incidencë më të lartë janë, Himara, Delvina, Tepelena etj.

Gjatë muajit korrik 2024 janë raportuar 90 raste të shtruara në spital dhe një rast vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 6.7% (81 raste) në ISHP dhe 93.3% (1124 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

7.2 Grip

Gjatë muajit korrik 2023, është raportuar vetëm 1 rast pozitiv me grip A në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Malarie

Për muajin korrik është raportuar 1 rast i konfirmuar në Laboratorin e Kontrollit të Vektorëve në ISHP me Malarie Plasmodium Falciparum. Rasti është i moshës 67 vjeç, gjinia femër, ardhur nga India.

8.2 Infeksioni nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV)

Gjatë muajit korrik në vendin tonë janë hasur raste me WNV, të konfirmuara pranë laboratorit të virologjisë në ISHP. Në total në korrik janë raportuar 46 raste nga të cilat janë konfirmuar 16 raste (35%).

Grafiku 8. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas fillimit të shenjave




Tabela 3. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas bashkive

Bashki	Raste të konfirmuar	% e pozitivitetit
Berat	3	18.75
Fier	4	25
Kavaje	1	6.25
Kurbin	1	6.25
Lezhë	2	12.5
Lushnje	5	31.25
Total	16	100

Vërehet numri më i lartë i rasteve i përket bashkisë Lushnje (31.25%) dhe Fier (25%). Rastet i përkasin të gjithë moshës mbi 60 vjeç, kryesisht gjinisë mashkull, janë të shtruar në spital ku kanë paraqitur shenja të encefalitit apo meningoencefalitit.

Nga ana e ISHP-së në bashkëpunim me NJVKSH dhe bashkitë përkatëse janë marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e transmetimit të sëmundjes.

8.3 Leshmanioza Viscerale

Për muajin korrik 2024 është raportuar 1 rast i konfirmuar në laborator privat me Leshmaniozë Viscerale nga Kruja.

DEKSI